

Nr. 118/15 prot.

Tiranë, më 10.03.2022

VENDIM

Nr. 19, datë 09.03.2022

“PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT PËR GJEGJËS NË NJËSINË E AUDITIT, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË, TIRANË”

Në bazë të neneve 3, 47, 49 (shkronja f) të ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Kodit të Punës së RSh; të Kodit të Procedurave Administrative; të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; të pikës 17 të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme...” të neneve 48, 49, 53 (pika 2) e vijuese të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të vendimit nr.63 datë 08.10.2021 “Për miratimin e kriterëve të punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”, bashkëlidhur kriteret dhe procedura, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 09.03.2022,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për plotësimin e vendit vakant, Përgjegjës në Njësinë e Auditit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë.
2. Ngarkohet Drejtorja e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore për fillimin e procedurave.
3. Ngarkohet Sektori i Koordinimit Institucional për publikimin e tij në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**



ANËTARË


MONIKA FIDA



ALBANA GJINOPULLI



VERA OSTRENI



ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFFERI



ENDRIT YZEIRAJ

